



Në bazë të Nenit 8 të Ligjit të Punës (Ligji nr. 03/L-212), UA MPMS nr. 07/2017 dhe Rregullores për Rregullimin e Marrëdhënies së punës 01/2710/2021, datë 09.11.2021 dhe Vendimin e Bordit të Drejtorëve me numër 01-827/2023 datë 04.04.2023 PK Sh.A. me datën 19.06.2023 shpall:

RI SHPALLJA E KONKURSIT PUBLIK PËR VENDE PUNE

Titulli i pozitës:

1. Postier/e, (grada 3) 2 Ekzekutes

Nr. Referencës: 01-827/2023 datë 04.04.2023

Përshkrimi: PK Sh.A., është duke bërë përpjekje për të zhvilluar biznesin sipas përvojave më moderne të shërbimeve postare dhe komerciale, për t'i arritur standardet ndërkombëtare në ofrimin e shërbimeve postare dhe komerciale. Në këtë aspekt, PK Sh.A., ofron mundësi të barabartë punësimi të profesionistëve që synojnë të jenë pjesë e zhvillimit të biznesit dhe kompetencave të Ndërmarrjes në përputhje me metodat dhe praktikat moderne.

Kohëzgjatja e kontratës: Konform nenit 4 dhe 15 të Rregullores për Rregullimin e Marrëdhënies së Punës për Punonjësit e Postës së Kosovës Nr. 01/2710/2021 datë 09.11.2021, kontrata e punës është për kohë të pacaktuar, në të cilën periudhë përfshihet edhe periudha provuese 6 muaj.

Pozita e punës: Postier

Vendi i punës: Regjioni Mitrovicë Veriore dhe Zveçan (2 ekzekutes)

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

Pranon dhe shpërndan letër-dërgesat, kolipostat, apo produktet tjera që ofron PK Sh.A., të ndara/ngarkuara nga kartuesi/ja; Është përgjegjës/e për pranimin, dorëzimin e letër-dërgesave, kolipostave në rajonin përkatës; Bën shitjen e produkteve sipas shërbimeve që ofrohen nga PK Sh.A. dhe është përgjegjës/e për arritjen e targeteve të caktuara nga qendra për shitjen e produkteve; Mban përgjegjësi për produktet e pranuar për shitje, tel. USSD, evidencë, klasifikim dhe ruajtje të dokumentacionit manipulativ në baza ditore, dekadore dhe mujore; Zbaton ndryshimet e paraqitura në lidhje me shpërndarjen dhe dorëzimin; Është përgjegjës/e për mirësjellje, zbatimin e Kodit të Mirësjelljes dhe Kodit mbi Trajtimin e Dërgesave Postare; Kryen edhe punë tjera të nevojshme të parashtruara nga Kontrollori i Shpërndarjes/Kartuesi apo Përgjegjësi i Zyrës Postare; Për punën e vet i përgjigjet Kontrollorit të Shpërndarjes/Përgjegjësit të Zyrës Postare.

Kualifikimi dhe përvoja e nevojshme:

- Punonjësi/punonjësja, për ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësi të Postierit/es duhet të ketë kualifikim të mesëm shkollor, preferohet në drejtimin e shërbimit postar.
- Njohja e gjuhës serbe është përparësi;
- Aftësi të mira organizative dhe komunikuese;
- Të jetë shtetas i Kosovës.

Dokumentacioni i kërkuar:

Kandidati, duhet t`i dorëzoj këto dokumente:

1. Aplikacioni për punësim (shkarkohet nga web-faqja e PK-së <https://postakosoves.com/publikime/mundesi-punesimi/>);
2. Deklaratën nën betim (e cila shkarkohet nga web -faqja e PK-së <https://postakosoves.com/ep-content/uploads/2021/09/Deklarata-ne%CC%88n-betim.-pdf.pdf>)
3. Diploma mbi shkollimin, (diploma e fituar jashtë Republikës Kosovës duhet të jetë e nostrifikuar sipas Ligjit);
4. Kopja e letërnjoftimit apo pasaportës valide;
5. Dëshmi nga Gjykata kompetente që ndaj kandidatit në fjalë nuk është duke u zhvilluar procedurë penale, jo më të vjetër se 6 muaj.

Konkursi është i hapur nga data 19.06.2023 dhe përfundon më datë 05.07.2023 në ora 16:00

Kandidatët që i plotësojnë kushtet fillimisht do t`i nënshtrohen testit me shkrim dhe vetëm ata kandidatë, të cilët do të kalojnë testin, do të hyjnë në rrethin e gushtë dhe do t`i nënshtrohen intervistës.